Lezhë, më 14.12.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 14.12.2023, në orën 12:00, në sallën e bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e këshillit të Bashkisë Lezhë.
Mbledhja u hap nga Kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës dhe theksoi që kemi projekt vendime shtesë, ku dy prej të cilave kanë kaluar nga mbledhja e muajit nëntor.

- Ndue Luli: Kush është dakord me rendin e ditës?
Miratohet me 28 vota PRO.
3 këshilltarë nuk votuan, konkretisht Alfride Marku, Kristian Gjidodaj, Emanuel Përgjoku.
Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që në bazë të vendimit që ka marrë KQZ-ja, ka të bëjë me plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Kristiandemokrate, znj. Silvana Kastriot Kola. Kush është dakord për dhënien e mandatit znj. Kola?
Miratohet me 31 vota PRO.
- Lexon formulën e betimit.
- Silvana Kola: Betohem.
- Ndue Luli: Vazhdojmë me projekt vendimin "Për miratimin e Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe Buxhetit Vjetor për vitin 2024"
Në lidhje me këtë p/vendim, fjalën e ka Kryetari i Bashkisë.
- Pjerin Ndreu: Së pari, përshëndetje të gjithëve.

Projekt Buxheti është dokumenti më i rëndësishëm për një institucion, siç jemi ne bashkia, ka. Është vlerësuar nga ana jonë në maksimumin e mundshëm, duke pasë parasysh dhe mundësitë financiare dhe vështirësitë. Ky buxhet është më i madhi në shumë se gjithë vitet përpara, 18.6 mld (të vjetra), pra 34% më shumë se dita që ne kemi gjetur buxhetin që ka pasë. Ajo që duhet thënë është se ne vazhdojmë me një balancim të buxhetit ku pagat, mallrat e shërbimet dhe investimet shkojnë në proporcion të drejtë, 36% shkojnë për pagat e sigurimet, 24% shkojnë për mallra e shërbime, pavarësisht se janë rritur kostot dhe çmimet në treg ne vijmë me ulje të shpenzimeve në këtë zë dhe 34% shkojnë për investime. Janë 6% te "Të tjera". Këtu ka qenë një disbalancim i frikshëm ku ka shkuar deri në 70% fondi i pagave dhe deri në 3% fondi i investimeve. Pra, ne vijmë me një buxhet të balancuar që realisht reflekton një pjekuri dhe një seriozitet, pra bashkia vazhdon të jetë një bashki shërbimi dhe jo punësimi. Gjithsesi një buxhet nuk mund t'i adresojë të gjitha problematikat që ne kemi, por që buxheti i vitit që vjen na organizon gjithë sistemin financiar, e vë në baraspeshë, duke zeruar borxhin dhe duke vazhduar investimet kryesisht në zonat rurale, si një ndër pikat më problematike që ne kemi në infrastrukturë sidomos. Pra, është një buxhet që

edhe për shkak të alternimit të disa investimeve të qeverisë, që do jenë prezent në vitin që vjen, që nuk do jenë pak, na mundëson që ne të hyjmë edhe në një bllok tjetër rrugësh rurale, ku qeveria me një program te Fondi i Zhvillimit ka hapur aplikimin dhe ne kemi aplikuar. Ka hapur program edhe për rikualifikimin urban të lagjeve të ndryshme, por ju them që qyteti nuk do të prekët për shkak se ne pretendojmë, sipas të dhënave dhe takimit që kam bërë unë me shefen e KFW-së në Tiranë, që deri në mars fillojmë punë. Është një investim prej 16,1 mln euro për kanalizimet e ujrave të zeza, disiplinimin e ujrave të shiut në Lezhë, për ujësjellësin e lagjes "Nënë Tereza", për ujësjellësin e Gocaj-Kakarriq, për ujësjellësin e Shëngjinit. Ndërsa jemi dakordësu dhe presim që të na financohen dhe 2 ujësjellësa të tjerë Mërqi-Kryeboshtë dhe Dajçi i Zadrimës. Do shpallet Milot - Balldre shumë shpejt. Na është thënë që do financohet rruga e Tobës për të bërë dalje në Shëngjin, jemi dakordësu me kryeministrin që të financojmë hidroporin, plus dhe një filozofi tjetër që në fakt vjen nga fermën e investimeve që ne e kemi aplikuar me shumë sukses - thirrjet - aplikimet për projekte të ndryshme që ne kemi bërë me fonde të ≠ të huaja, me programe crossboarde të BE, me qeverinë zvicerane dhe austriake kemi fituar

kemi fituar me Ministrinë e Rinisë, pra kemi fitu të paktën 11 projekte nga zero projekte të fituara para nesh. Ne vazhdojmë përpara. Vetëm këto ditë kemi fitu dy projekte të tjera: për ndriçimin rural 400 mln nga fondet e BE-së dhe çertifikimin me BLUE FLAG të plazheve të Shëngjinit që është rasti i parë që ndodh në Shqipëri, që do të thotë që reputacioni i tyre ngrihet në nivel tjetër. Shumë shpejt do fillojë muzeu arkeologjik në Kalë, e cila do ketë investime nga BE për restaurimin e saj në kuadrin e tërmetit. Ne vitin tjetër zbërthejmë përfundimisht gangrenën e lejeve të ndërtimit - bllokimit të tyre. Taksën e ndikimit në infrastrukturë nuk e kemi patur për 4 vjet por nuk na ke parë kurë duke tjetur, por kemi dalë në punë. Vetëm me dy aplikime që besojmë që kalojmë brenda muajit, ku njëri është rasti që do kalojmë sot, ne kryejmë punë.
Ne pretendojmë që pse jo, vitin tjetër të kemi një buxhet me rishikim me shtim.
Ne do vazhdojmë me projekte. Jo më larg se sot ne kemi nisur bashkë me drejtorin e Urbanistikës një projekt për eficiencën e energjisë në gjithë institucionet arsimore, sociale, kulturore shtetërore, ku ne propozojmë një fature të jashtëzakonshme energjie.
Nga ambasada japoneze, më të cilën kemi

marrëdhënie shumë të mira, na është premtuar që do na sjellin 2 ekskavatorë të rinj, për vazhdimin e punës me kanalet kulluese, që për hir të së vërtetës, e them me krenari, s'e kemi ndalë punën asnjë ditë. Nuk kemi shitur asnjë litër naftë në treg të zi. Në lidhje me përmbytjet, nuk e kemi më hasur në atë që e kemi pasë. Është reduktu në mënyrë të ndjeshme në tre pika të cilat duhen zgjidhje që nuk kanë lidhje me kanalet, por duhen zgjidhje tjetër. dhe hidrovori i fushës së Torovicës është një problem, rruga poshtë që shkon për Blinisht është po një problem se është shumë e ulët dhe është problemi i Zajsit e Grashit që do ishte shumë më i madh po mos të kishim ndërhyrë ne.

Pra, në kompleks bordi është një institucion që punon, por edhe ne kemi ato problemet tona se nuk jemi perfekt. Ka plot gjëra që duhen riparë, ka plot kërkesa që nuk i adresojmë dot, por me ecurinë që kemi, do jemi në kohën e duhur. Unë do ta ndërpres këtu për ta zhvilluar diskutimin me pyetjet tuaja. Faleminderit.

- Nazire Luli: Paraprakisht dua të falenderoj të gjitha Komisionet që sipas datës së caktuar kanë funksionuar mirë dhe shumë mirë për të diskutuar në lidhje me PBA 2024-2026 dhe buxhetin 2024, madje diçka duke dërguar në komisionin e Financës

propozime konkrete. Për këtë arsye, fjalën do ia japim kryetarit të Komisionit të Financës, z. A. Marku.

– Agostin Marku: Faleminderit kryetar. Gjej rastin të falenderoj për bashkëpunimin gjithë komisionet sepse sipas një kalendari të përcaktuar nga Kryesia e Këshillit janë mbledhur dhe gjithsecili komision që ka pasë vërejtje i ka sjellë te komisioni i Financës i cili i ka shqyrtuar ato por dhe gjithçka që ka ardhur në rrugë zyrtare nga këshilltarë të veçantë pranë kryesisë së këshillit dhe ka dalë në konkluzione duke i konsultuar dhe me drejtoritë përkatëse dhe komisioni i Financës në tërësi del me mendimin që është një pozitive se kemi buxhetin më të madh të gjithë kohërave në Bashkinë e Lezhës, në një shifër afër 1,8 mld lekë, çka flet për seriozitetin dhe ambiciet që ka vetë bashkia për të stabilizuar treguesit makroekonomikë por dhe për një zhvillim strategjik të Bashkisë Lezhë me ato objektiva që ka edhe në fushën e turizmit duke synuar një grumbullim të ardhurash sa më të larta, për t'iu përgjigjur dhe kërkesave në rritje për shërbime publike që ka komuniteti. Një pozitive që duhet ta vlerësojmë në këtë buxhet është fakti që treguesit më të mëdhenj në strukturën e shpenzimeve vijnë te shërbimet publike që është pothuajse 49% e buxhetit në total dhe shpenzimet e bujqësisë me 16%, çka flet për një seriozitet të punës së

bashkisë, që të gjitha të ardhurat i fokuson aty
ku nevojat janë edhe më të mëdha për komunitetin.
Treguesi i veçantë që ne duhet të theksojmë, është
se bashkia këtaj radhe e ka fokusin te infrastruktura.
dhe po të shikojmë, në 39 objekte të investimeve,
rreth 86% e investimeve shkojnë për infrastrukturën,
pra që ky është një tregues shumë i lartë dhe pozitiv,
në një buxhet bashkie. Krahas kësaj vlen të theksohet
dhe çështja e organikës. Ne kemi një organikë të
stabilizuar. Sa i përket burimeve të bashkisë, kemi
një organikë modeste, pra nuk mund të themi që
kemi luks në organikën e bashkisë, gjë e cila ka ulur
jashtëzakonisht shumë, pavarësisht rritjes së kostos
së materialeve, rritjes së ndjeshme të pagave.
Numri i punonjësve nga burimet e veta, nuk i kalon 500.
Pjesa tjetër është nga shërbimet sektoriale, që kemi
atë shifrën prej 800 e ca vetë që ne i miratojmë
së bashku me buxhetin. Megjithatë, më lejoni të them
dhe disa tregues të tjerë që ndoshta duhen marrë
në konsideratë edhe nga vetë bashkia gjatë imple-
mentimit të buxhetit, si në drejtim të grumbullimit të
të ardhurave, ashtu dhe në shpenzimet. Buxheti i bashkisë
nga të ardhurat e veta kapë shifrën 59%. Pjesa
tjetër 41% është nga granti e shërbimet sektoriale, pra
të kompetencave të deleguara që i vjnë bashkisë, që
është një fond i paravitur sepse na vjen nga qeveria
por te pjesa 59% është nga efiçienca menaxheriale

që ke vetë bashkia për të mbledhur të ardhura dhe performance e buxhetit në fund del nga kjo.

Po të shohim te ndarja taksa – tarifa, pjesa dërrmuese shkon te taksat që e kemi 58%, por mesa 65% të kësaj takse është planifikuar që të merret nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila është një taksë që mund të realizohet edhe më shumë, por mund të ndodhë dhe e kundërta sepse nuk janë të gjitha në dorën e bashkisë. Varet nga planet strategjike, varet nga planet e qeverisë, gjë e cila mund të çojë në një pikëpyetje implementimin e buxhetit. Komisioni doli në këtë konkluzion ngaqë nuk kemi një përvojë të mirë në këtë fushë sepse në pjesën dërrmuese, kjo taksë nuk ka mbarritur te gjendja e menaxhimit nga ekipi përkatës që i takon të merret. E themi këtë dhe për një rast tjetër se po të shohim investimet publike, një pjesë e konsiderueshme janë planifikuar mbi bazën e të ardhurave dhe jo nga granti. sepse grantet në pjesën dërrmuese vijnë të përcaktuara. Si rezultat i kësaj, të gjitha ato dokumenta që ka bashkia si për infrastrukturën e rrugëve rurale apo dhe për pjesë të tjera që i ka gjykuar si më të rëndësishme, na rezulton se janë te pjesa e të ardhurave. Gjendja e realizimit të të ardhurave ka çaluar ndër vite në bashki. Po të shikojmë planifikimin e të ardhurave sipas fushave të përcaktuara, na mendojmë si komision se ka rezerva përsëri te

disa takse te planifikimi, gjë e cila ishte një përvojë jo e mirë në shumë vite, por mendojmë që me një step të konsoliduar tashmë, duhet që edhe ambiciet t'i kemi më të mëdha. Realisht ka rezerva në planifikim, sidomos te taksa e fjetjes në hotel, te zënia e hapësirave publike që hyjnë në resurse që i ka Bashkia e Lezhës. Kemi diçka te taksa mbi tokën bujqësore. Është e vërtetë që ka vështirësi, edhe mentaliteti i fermerit në këtë drejtim lë shumë për të dëshiruar, por ne mendojmë se bashkia duhet të punojë në këtë drejtim me projekte konkurruese, pra që të fiksohen edhe në buxhet, që të nxisin mbledhjen e kësaj takse, duke futur në konkurrim njësitë administrative. Ne e dimë që kemi fusha shumë të mëdha si ajo e Bregut të Matës, ajo e Torovicës, e Zadrimës që i kanë lokale shumë njësi të tjera vendore. Atëherë si do ta lehtësojmë këtë mundësi për të mbledhur të ardhurat në faktor përmirësimi i treguesve financiarë në Bashkinë e Lezhës. Mentaliteti është ai që është, por p.sh. ne futim projekte konkurruese në këtë drejtim duke nxitur nj.a. që ato që mbledhin më shumë të ardhura, duke i dhënë edhe projektin direkt për vaditjen, për kullimin, për shërbime të tjera që ndikojnë për fermerët, do ndikojë në ndërgjegjen e gjithsecilit për pagesën e kësaj takse e cila është e ligjshme. Po ta

shohim vlerën e planifikuar, me vitet e tjera, është vlerë e lartë, po të shohim në fakt me atë që kemi në dispozicion, për ato resurse që ka bashkia, kjo është shumë e ulët, 100 mln lekë të ngritura për gjithë vitin, që e ulë lë për të diskutuar. Në tërësi, ne mendojmë se duhen bërë ca rregullime në buxhetin e bashkisë, të cilat janë p.sh. në drejtim të sektorit të pyjeve. Komisioni i financës, edhe me propozimet e Komisionit të Bujqësisë, arriti në një konkluzion që ndoshta duke futur projektet e mbarështimit të pyjeve do arrijë që ta kthejë këtë sektor në fitimprurës, jo vetëm shpenzues. Edhe kjo mund të arrihet nëse këto projekte, për të cilat ne kemi informacion që ndodhen në Bashkinë e Lezhës, zbatohen. Investimi në pyje do ndikojë edhe në çështjen e disiplimit të ujrave. Këtë e kojojim për diskutim me këtë bashkinë sepse dihet që ka të bëjë me kosto financiare. Në fushën e turizmit, pavarësisht se drejtoria përkatëse ishte shumë e kënaqur sa i përket shifrave, edhe pse janë të ulta, por komisioni përkatës kishte mendimin që në fushën e marketingut, kur ne synojmë që në këtë fushë të sigurojmë një shumë të konsiderueshme të ardhurash, të merret në konsideratë edhe të kete një shtesë fondi në fushën e marketingut të vlerave turistike që ka bashkia. Në fushën e arsimit, gjithashtu edhe Drejtoria e Arsimit ishte e kënaqur me shifrat që ka në parashikime, por komisioni përkatës ishte në një mendje që t'i

Kushtohet një vëmendje më e veçantë dhe me shifra
konkrete për sa i përket sistemit të ngrohjes, është
edhe një vërejtje që ka ardhur nga këshilltarja A. Marku.
Ne e thamë që jemi marrë të gjitha masat si me dru
zjarri, ashtu dhe me punën që po bëhet nga bashkia
në lidhje me panelet diellore, me projekte që mund
t'i bëjmë dhe me financime të huaja dhe do të
realizohet. Te çerdhet dhe kopshtet e dimë që
është problem i mbyllur, por kjo të shtrihet dhe në
sistemin e arsimit parauniversitar. Një gjë tjetër
që është dhe mendim i komisionit të Urbanistikës,
që dhe kryetari i bashkisë e ka deklaruar, Bashkia
e Lezhës për vetë pozicionin që ka sot, vëmendje
të veçantë duhet t'i kushtojë çështjes së projekteve.
Në zhvillimit duhet t'i paraprijmë me projekte ambicioze,
të cilat kanë një kosto financiare, dhe kërkojmë
mendimin e specialistëve dhe angazhimin e shumë studiove.
Ne shohim që ka një fond të caktuar aty për to,
por ne duket se me ato ambicie që ka bashkia,
është e nevojshme që të shtohet. Dhe e fundit,
ato bashki që kanë financa të shëndosha, kanë
krijuar një buxhet më vete për këshillin e Bashkisë,
jo se Bashkia Lezhë nuk e ka në zërat e shpenzimeve,
por kur këtë nuk arrijmë ta nxjerrim në zë të veçantë,
që është dhe kërkesë e institucioneve financiare
ndërkombëtare, edhe e një agjencie që funksionon
këtu në Shqipëri që nga viti 2015 për "Bashki të Forta"

por është dhe në legjislacionin shqiptar e përcaktuar mjaft mirë, duhet që ta nxjerrim në zë të veçantë. Në tërësi këto janë vërejtjet. Kishte edhe propozime të tjera, që ne i morëm në konsideratë për t'i debatuar në mbledhjen e komisionit, por dhe me drejtoritë përkatëse, të cilat një pjesë e konsideruan e tyre, se i takon çështjes së infrastrukturës, ju thashë që janë dhe tregjet në të mirë lidhen me këtë. Se i takon disiplinimit të kanaleve të ujërave të bardha e të zeza, çështjes së ujit të pijshëm, disa herë Kryetari i Bashkisë e ka thënë, ka një projekt gjerman, që për arsye pandemie është shtyrë por jo për mos t'u realizuar. Ka një zhvendosje në kohë, por është gjë pozitive se është një çështje që kërkon shuma të mëdha financiare, që bashkia me burimet e veta e ka të vështirë. Nuk kemi pse të diskutojmë në lidhje me buxhetin e bashkisë. Ka një ide tjetër se i përket qendrave për moshën e tretë për Shëngjin, Lezhë, Balldren, Shënkoll. Nga Drejtoria e Financës na u tha që këto funksionojnë në Shëngjin, Lezhë, Shënkoll, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, me organizata të tjera. Shtrohet çështja e Balldrenit. Ndoshta në kuadrin e bashkëpunimit që keni me Kryqin e Kuq, mund ta shtrini dhe në Balldren z.Kryetar. dhe mund të bëhet dhe zgjidhja e këtij mendimi të drejtë që është nga këshilltarë të veçantë. Janë dhe disa

probleme të tjera që kërkojnë kosto të larta financiare, por që ne themi që nuk janë në dorën tonë. Ka diçka për erozionin e bregdetit. Është një çështje që nuk është në juridiksionin e bashkisë, por ka të bëjë me Agjencinë e Bregdetit. Kuptohet që bashkia duhet të shprehë shqetësimin, duhet të nxisë dhe të inkurajojë institucionet përkatëse që të merren me atë problem dhe ta vlerësojnë. Është një problem serioz, por nuk është diçka që mund të përfshihet në buxhetin e bashkisë. Ka pastaj çështje të tjera për ndërhyrje në lagjet e qytetit, në lagjen e Spitalit, në lagjen Skënderbej. Këto, unë them që janë të përfshira në ato projekte që ka bashkia për infrastrukturën urbane në qytetin e Lezhës por dhe rrugët rurale në njësitë e tjera administrative. Një vërejtje që kishte komisioni, por që unë dhe në propozimet e zonjës A. Marku është që investimet në rrugë duhet të specifikohen, jo kështu e përgjithshme. Këto janë pak a shumë ato që u thanë nëpër komisione, u konkluduan në komisionin e Financës dhe kërkojmë që duke marrë materialin që ne e studiuam më të mirin, me këto propozime, ta miratojmë në këtë mbledhje, duke u kërkuar këshilltarëve që në diskutimet e tyre të jenë sa më racionalë dhe këto që ne i themë këtu dhe janë thënë nëpër komisione, mos t'i kalojnë në përsëritje. Faleminderit.

- Ndue Luli: Faleminderit z. Marku. Te komisioni i

Financës ka të drejtë çdo këshilltar, çdo komision, e më tepër çdo kryetar grupi politik, të marrë pjesë. Tani kalojmë te pyetjet. Po zj. Marku.

– Alfride Marku: Flm. Përshëndetje të gjithëve.
Sa i përket PBA-së 2024-2026 dhe buxhetit për vitin e ardhshëm, pasi e kam studjuar, unë mendoj që nuk reflekton problemet kryesore prioritare që kanë banorët e Lezhës si dhe nuk paraqet një plan apo strategji afatgjatë që Bashkia Lezhë ka në mënyrë objektive dhe të qëndrueshme për zgjidhjen e tyre. Ju mund të thoni që është buxheti më i madh i kushedi sa viteve. Po, kemi 1,8 mld lekë të parashikuara në buxhet, por kjo shumë nuk i adresohet problemeve të qytetarëve. Në fjalën e tij kryetari i Bashkisë tha që më kemi drejtuar disa letra. Z. Kryetar, ato letra nuk janë as më shumë e as më pak veçse një listë e prioriteteve dhe problemeve kryesore që kanë banorët e Lezhës dhe në emër të mundësisë për t'i përfaqësuar ato këtu, ne jua rikujtojmë, jua adresojmë që t'i përfshini në buxhet për t'i realizuar.

– Pjerin Ndreu: Pse s'i bëre ti për 4 vjet?

– Alfride Marku: Është e vërtetë që për 1 vit nuk mund të zgjidhen, ama për 4 vjet zgjidhen shumë probleme. Vota ime për buxhetin e propozuar nga Bashkia Lezhë do të jetë kundër për disa arsye. Së pari, lë në harresë bujqësinë dhe turizmin. Anashkalon problemin e përsëritshëm të përmbytjeve, duke

marruar domosdoshmërinë për të ndërhyrë një orë e më parë në rrjetin e kanalizimeve në qytet si dhe në sistemin e kanaleve ujitëse e kulluese në zonat rurale, në tokat bujqësore. Nuk i hap rrugë zgjerimit dhe zhvillimit të zonës urbane me standarte bashkë-kohore që është kaq urgjente për Lezhën. Nuk para-shikohet asnjë masë për të zgjidhur problemin e furnizimit me ujë të pijshëm në zonën bregdetare të Shëngjinit, që ka penalizuar mjaft sezonin e turizmit dhe biznesin e asaj zone, në lagjen "Nënë Tereza", në pjesën e mbetur të njësisë Balldren dhe në njësinë e Dajçit. Asnjë projekt nuk parashikohet në buxhet për shtimin e hapësirave të gjelbra, rehabilitimin e qendrave të njësive administrative. Nuk parashikohet asnjë masë e.Luhi për minimizimin e erozionit detar, pavarësisht se ju thatë që nuk është kompetencë e bashkisë, ama bashkia nuk duhet të tërhiqet por duhet të adresojë problemin tek autoritetet kom-petente. Asnjë kopësht apo çerdhe e re nuk parashikohet për t'u ndërtuar, kryesisht në qytetin e Lezhës, çka duhet ta pranojmë që është emergjente. Bashkia Lezhë nuk ka parashikuar asnjë masë për rehabilitimin e përroit të "Manatisë", që përshkon duke ndotur një pjesë të konsiderueshme të qytetit, asnjë masë për ndërtimin në kushte bashkëkohore të tregut industrial dhe tregut ushqimor si dhe për të përmirësuar kushtet në

tregjet e vogla të produkteve të familjeve të zonave rurale, të bulmetit dhe fruta-perimeve. 97% të buxhetit të vitit 2024 apo 5,3 mld lekë, që ju po propagandoni 18 mld lekë për investime, janë parashikuar në letër për rehabilitimin e rrugëve, pa u shoqëruar me një plan konkret se në cilat rrugë konkretisht rurale apo urbane, në cilën njësi administrative, në cilin fshat, në cilën lagje, Bashkia Lezhë do të ndërhyjë. Mungesa e transparencës lë vend për abuzime dhe jo rastësisht sepse viti 2024 siç e dimë është dhe vit parazgjedhor. Në asnjë fushë tjetër nuk ka investime kapitale për 2024 dhe vetëm 12,4 mln lekë shpenzime kapitale janë parashikuar për arsimin, rininë dhe sportin. Vetëm 2 mln lekë shpenzime kapitale janë parashikuar për përkujdesjen sociale dhe strehimin, nuk është sqaruar se çfarë masa do të marrë bashkia për problemin ende të pazgjidhur të rehabilitimin e pasojave të tërmetit. Vetëm 2,5 mln lekë shpenzime kapitale janë parashikuar në turizëm dhe kulturë, ndërkohë për të mëdijërmet pesha buxhetore është 408,7 mln lekë apo e thënë ndryshe 24 herë më e lartë sesa investimet e papërfillshme. Kemi më shumë shpenzime për paga sesa për investime. Në buxhetin e 2024, që flitet pas fjalës rehabilitim të rrugëve pa parashikuar asnjë rrugë konkrete, duke i dhënë mundësi abuzimeve

me vitin 2025 që të peshën më të madhe buxhetore por pa projekte që adresojnë problemet kryesore të banorëve, e këtu ritheksoj që viti 2025 është edhe vit elektoral, viti 2024 është paraelektoral, prandaj ju me doemos krijoni mundësi abuzimi për t'i paraprirë këtyre dy momenteve të rëndësishme. Buxheti i propozuar nga bashkia nuk adreson problemet e qytetarëve por llogaritë politike të drejtuesve të Bashkisë Lezhë dhe ankthit të garës elektorale apo përballjes me qytetarët. Jam e bindur që për vitin 2024, arritja më e madhe e Bashkisë Lezhë do të jetë të mbajë hapur dyert e njësive administrative dhe se me taksat tona do të keni mundësi të paguajë vetëm propagandën që për hir të së vërtetës meritoni notën 10.
Sa i përket asaj letre që ju me shpërfillje e përmendët, unë dua t'ju rikujtoj se me dy shkresa i jam drejtuar Këshillit të Bashkisë duke propozuar zyrtarisht amendime të cilat, në bashkëbisedim me qytetarë, me ekspertë, me grupe interesi, që se kam pasur mundësi, i konsideroj prioritare, jo thjesht për një vit buxhetor, por që të jenë të shtrira në një plan afatgjatë 4-vjeçar të Bashkisë Lezhë.
Ju mund të pretendoni që jenë projekte që B. Lezhë nuk ka mundësi financiare që t'i realizojë, ama ju e dini shumë mirë që sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, përgjegjësia për shërbimet publike dhe investimet është jo vetëm vendore por edhe qendrore,

dhe në këtë rast, siç besoj, e kemi dhe derën e hapur tek qeveria për të kërkuar bashkëfinancim. Për transparencë për kolegët këshilltarë edhe për qytetarët

- Ndue Luli: Edhe 2 minuta.
- Alfrida Marku: Më lejoni shkurtimisht vetëm të nominoj ato pika që unë i konsideroj të arsyeshme të ndryshohen në projekt buxhet; ndërhyrje për rehabilitimin dhe ndërtimin e plotë të infrastrukturës vaditëse e kulluese në gjithë sipërfaqen e tokave bujqësore në Bashkinë Lezhë dhe kjo jo për 1 vit por në 3 vitet e ardhshme, ku siç nëse nuk kemi mundësi financiare, e ritheksoj, duhet dhe mund të kërkoni bashkëfinancim nga qeveria, një projekt i detajuar mbi bazën e të cilit bëhet i mundur rehabilitimi i plotë dhe ndërtimi i infrastrukturës së ujrave të bardha në njësinë administrative Lezhë dhe Shëngjin, për problemin e përmbytjes disavjeçare në qytetin e Lezhës dhe në Shëngjin duhet të zgjidhet brenda 3 viteve të ardhshme. Gjithashtu edhe ndërhyrje në infrastrukturën kulluese në tokat bujqësore për të zgjidhur problemin e fermerëve për përmbytjet në zonat bujqësore.
- Ndue Luli: Znj. Marku dua të të them që të gjitha këto që po lexon tani, i ke paraqitur në kryesinë e këshillit dhe në këto u mor dhe komisioni i Financës.
- Alfrida Marku: Nuk janë nominuar të gjitha, kështu që unë për transparencë do i them.

- <u>Ndue Luli</u>: Por ti përmende dhe ato që janë përmendur. E dyta, unë them kush ka pyetje dhe të fillojmë me diskutimet.
- <u>Alfride Marku</u>: Mos u shpetisni për problemet e pyetësorëve. A do t'i them në trajtë pyetjesh? Dakord. A ka zgjidhje Bashkia Lezhë për problemin e ujit të pijshëm në zonën bregdetare të Shëngjinit, në lagjen "Nënë Tereza", Ballaj dhe Dejç? A ka zgjidhje B. Lezhë, apo plan për rikualifikimin e plotë, me parametra bashkëkohore për lagjen e Spitalit dhe lagjen Skënderbeg, për të bërë të mundur zgjerimin e zonës urbane me standarte bashkëkohore? A ka plan B. Lezhë për ndërtimin e një parku të madh të gjelbëruar në lagjen "Skënderbeg" duke i hapur rrugë projektit gjithashtu për qytetin e Lezhës me disa pendone të zhvilluara? A ka një projekt B. Lezhë për shtimin e terreneve sportive? A ka plan B. Lezhë të rehabilitojë rrugët e brendshme në të gjitha njësitë administrative, konkretisht në cilat rrugë planifikoni të ndërhyni? Kam propozuar gjithashtu projektin "Një nxënës, një pemë", ku me financimin e bashkisë të nisë mbjellja e pemëve në çdo njësi, si fokus 2 vitet e para të jetë njësia Lezhë, kryesisht zona e Kalasë, kurora e lagjes së spitalit, Lagjja "Skënderbeg" dhe "Gurra" çka do të sillte drejtpërdrejt efekte mjedisore si dhe do të minimizonte përmbytjet. Kam propozuar

gjithashtu ndërtimin e bibliotekës publike në qendër të çdo njësie administrative.

- Ndue Luli: I kemi propozimet. Të lutem. Mbaroi koha.

- Alfrida Marku: Kam propozuar ndërtimin e qendrave të moshës së tretë në çdo nj.a në 3 vitet e ardhshme, ndërtimin e tregut industrial dhe ushqimor me parametra bashkëkohore, përmirësimin e kushteve në tregjet e vogla të produkteve të bulmetit dhe fruta-perimeve, ndërhyrje urgjente për pastrimin dhe rikualifikimin e përroit të Manatisë, një projekt për minimizimin e erozionit të zonën bregdetare, kryesisht në zonën e Kunes në Shëngjin si dhe rehabilitimin e fushave ekzistuese dhe ndërtimin e tyre atje ku mungojnë si dhe rikonstruksionin e palestrave, kryesisht këtu gjendjen e papërfundemar të palestrës së shkollës "Gjergj Fishta", në të gjitha shkollat e Lezhës

- Ndue Luli: Koha ka mbaruar znj. Marku. Të lutem respektoje

- Alfrida Marku: E fundit, kam propozuar që brenda vitit 2024, Bashkia Lezhë t'i japë fund një herë e mirë problemit të ngrohjes nëpër shkolla sepse siç po na vijnë info nga prindërit, kryesisht në shkollat e qytetit, tani në periudhën e dimrit ka probleme me ngrohjen. Kaq kishja.

- Ndue Luli: Faleminderit. Ne duhet të dimë

që jemi Këshill Bashkiak. Secili nga ne ka edukatën, etikën e vet, kulturën e vet. Tani, të ftosh drejtuesi i mbledhjes se kush ka pyetje e të nisësh diskutimin, kjo është tamam që mezi po prit me marrë një mikrofon në dorë dhe me lexu edhe njëherë shumë nga ato pike që kryetari i komisionit të Financës i lexoi këtu duke përmend edhe emrin e këshilltares që i ka propozuar.
Shumë pyetje pati znj. Marku edhe fjetë diskutimit sepse e kren dhe diskutimin. Mund të fajësh përgjithësi dikush nga bashkia.
- Tjerin Ndreu: E nderuar këshilltare, komplimente se ke filluar të shpetëshosh që kur je bërë këshilltare se sa ke qenë nënkryetare s'e ke vrarë mendjen fare dhe s'ke bërë asgjë, se të kishe spikatur në një fushë nga këto që rendotove ti, do na kishe lehtësuar shumë neve si stof bashkie dhe këshilltarët.
E dyta, protagonizmi jot për të bërë politikë me ça të gjesh problematikë e me i fut në një thes e me i sjellë këtu para këshilltarëve, për t'i treguar gjoje popullit se ti je e shpetëshuara e madhe kurse ne të tjerët jemi duke e mbytur në një Lethën, kur në fakt ti, bashkë me stafin që ke pasë, je promotorja e degradimit total të asaj bashkie. Në 2015 zonjë, ke lënë 70% të fondit për paga, vetëm 3% për investime, nuk po hyjmë te borxhet se pastaj riciklojmë

njëri-tjetrin. Më konfirmon gjithë kjo histori se ti ke hyrë e ke dalë prej asaj bashkie e s'ke kuptuar asgjë. Është kulmi kur ti si ish zyrtare e bashkisë, vjen dhe adreson gjithë këto probleme. Përmend gjëra që unë sapo i shpjegova. Ujësjellësin Gocaj-Kokomrip e kam futur unë se kur ke qenë ti bashkë me atë veshtrinë tënde nuk ke pasur një letër projekt, asnjë. Sot që ne flasim, ne i kemi adresuar projektet dhe fillojmë me ujësjellësin e Zejmenit, në Tale. Është kulmi i abuzimit tënd kur ti thua ato që në fakt janë në proces. Është një sjellje jo e denjë, se mua asgjë nuk më bën. Mua më jep kënaqësi sa herë ti e nxjerr veten të paaftë. Të vetmen gjë të hajrit, ke thënë me mbjellë pemë. "Një nxënës - një pemë". Jam plotësisht dakord me ty, duhet bërë.

- Alfrida Marku: Votoje pra, të përfshihet në buxhet.
- Pjerin Ndreu: Po, ta kalkulojnë fondin, sa na duhet, pra. Shkon e thua pemë të moshës së tretë për çdo njësi. Me thua një vend të botës që ke? Që ti s'kupton asgjë si funksionon një bashki e ke shfaqur. Kam pasë përshtypje tjetër në fillim, duke qenë në bashki do i kesh mësuar tre gjëra. Të bësh opozitë me pikë por s'ke kapur asnjë pikë. Më vjen keq për kolegët e tu si të durojnë ty kur thua të tilla gjëra. Në lidhje me rrugët, ne e kemi bërë planin, për

gabim teknik nuk e ke reflektuar Ermali, por ne nuk do hyjmë në plan se nuk të lë kush të shpenzosh në projekt. Teoria e abuzimit është fantazi e gënjeshtër që nuk ndodh, nuk ke shans. Rezervoj të drejtën të mos të të përgjigjem nëse ti bën këtë politikë turpi. Se ke qenë ti në bashki nuk të ke parë kush kurrë duke u shqetësuar për hallet e miletit, vetëm me i zënë vrugën kryeministrit. Ti s'ke bërë asnjë punë në bashki se nuk njeh asgjë dhe e tregon këtu.
Meqë më the që e kam forcuar te peveria, e kam forcuar me projekte. Ti nuk ke çuar asnjë. Më thuaj një projekt që ke çuar në peveri?
Ti ke çuar 35 kërkesa financimi por asnjë letër projekti asnjë. Ju jeni shtrumbulleri i degradimit të Bashkisë Lezhë sepse ke punë me njerëz të kupe, me high risk, sot e ke me fëshile dhe kjo është e monitoruar. Më thua mua Gocaj-kokerrip? Po ti ke shkuar i ke çuar njerëzit atje në një, me raste skandaloze. Ajo është tjetër. Vjen këtu duke më treguar mua kush je ti. Po kush je ti? Ça përfaqëson? Ku e ke ti rezultatin? Ti s'bëhesh politikane e madhe. Je cinike. Ti nuk përfaqëson dot komunitetin. Ti nuk bind dot asnjë.

— Dolën dhe u larguan Këshilltarët Flutura Gjeni dhe Fjorixhena Zefi.

— Agostin Marku: E ndjej të nevojshme të bëj një sqarim. Ne kemi një projekt vendim para për buxhetin, i cili i ka shifrat mjaft qartë. N.q.s dikush këtu ka një p/vendim tjetër alternativ që do që bashkia ta implementojë, atëherë jemi gabim ne. Nga ky p/vendim është qartë që programet buxhetore janë 7. dhe po ju them shërbimi i administratës ka 13,7 % të shpenzimeve të përgjithshme, siguria dhe rendi 6%, çështjet e përgjithshme ekonomike 8 %, 49 % e ka infrastrukture, mjedisi te shërbimet publike, pra janë shifra aty, s'i ndryshojmë dot. N.q.s janë të paqarta, n.q.s janë dhe që nuk na pëlqejnë, hajde të bëjmë dhe propozime konkrete. 16 % e ka arsimi, rinia dhe sporti, 4% e ka përkujdesja sociale dhe strehimi. Po të vijmë sipas strukturës, i kemi i pagat 31 %, sigurimet 5 %, mallra dhe shërbime 24,5%, që një pjesë që shkon këtu mund t'i konsiderojmë dhe te investimet sepse nuk janë për leka apo për mbajtjen e administratës të gjitha, dhe vijmë pastaj që kryesojnë, 34% investimet publike. Vijmë te çështja e rrugëve. Ne e bëmë vërejtjen dhe bëmë propozimin. Buxheti të kalojë me miratimin duke i specifikuar aty ku janë te rrugët. Vetëm 5 % e investimeve janë parashikuar për shërbime ndaj administratës. Është shifër e ulët, duke pasur prioritet investimet publike te çështjet e infrastrukturës. Këto janë flogeri me tabelë

shumëzimi dhe jo me llogari 7x7=42. Faleminderit.

- Ndue Luli: Vazhdojmë me pyetje. Po z. Marku

- Rrok Marku: Z. kryetar ju dëgjova për investimet në ujësjellës. Është një ujësjellës në Nj. A. Blinisht që ka 24 vjet që është bërë, në Piraj. A është në plan vitin e ardhshëm për t'u bërë? Projekti, që ka thënë drejtori, është gati. Aty merr ujë vetëm një pjesë e fshatit, pjesa në kodër.

- Pjerin Ndreu: Unë do konsultohem me drejtorin. Në bashki nuk ka projekt për Pirajn, që të jemi realistë. Projekti që kemi shtrihet në pyjet me kanalet e ujrave të zeza dhe të shiut, në lagjen "Nënë Tereza", Shëngjin dhe Gocaj-Kakarriq, dhe Gocaj-Kakarriq se për dijeni është bonus që ua kam kërkuar unë. Do zgjidhim problemin e 2 ujësjellëse këtë vit, të Mërqi-Rraboshtës dhe të Dajçit. N.q.s. e ka projektin drejtori, do e aplikojmë. Do interesohem.

- Ndue Luli: Vazhdojmë me pyetjet. Po znj. Ndoj.

- Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve. Në fakt në aparencë duket një plan i të ardhurave dhe i shpenzimeve i kopsitur mirë, por pa hyrë shumë në hollësi, unë do flas në këndvështrimin tim. Duke qenë se jam mësuese, kemi parë kohët e fundit problematikën e largimit të nxënësve. Klasat po na boshatisen, mësues do dalin të papunë, disa shkolla madje do të mbyllen, por nga ana tjetër dihet, se po largohet një forcë konsumatore

një forcë rinore, një grupi punëtore, të cilët janë tatimpagues, janë taksapagues. Pyetja ime është se se do të jeni gati në gjendje për t'i vilni këto taksa, duke parë këto ndryshime demografike si dhe duke parë dhe nivelin ekonomik të pyetësorëve (?) lexojmë sepse nga 2024 deri në 2026 vërejmë një rritje të të ardhurave. Se do të jetë e aftë administrata juaj për t'i mbledhë këto të ardhura përballë këtyre problemeve demografike për ka kaha apo dhe gjithë Shqipëria, dhe këtij niveli ekonomik? Faleminderit.

- Gjerin Ndreu: E para shumë faleminderit për pyetjen konstruktive. Është pyetje fiks për buxhetin. Është më se e vërtetë ajo për thua. Ikja, lëvizja e njerëzve krijon dhe problemet e veta sepse bie numri i konsumatorëve, bie numri i bizneseve për pasojë. Ne, po ta shikosh, edhe në këto vite, pavarësisht se kemi pasur në vështirësi, atë tërmet, atë pandemia, atë krizë e rëndë ekonomike, ne nuk është se i kemi përpëndruar t'ardhurat në zonat rurale, pavarësisht se investimet i kemi çuar atje, nuk është se është reflektuar drejtpërdrejt pesha e taksave të zonave rurale. sepse Zejmen, Kolsh dhe Shënkoll në rreth 1400 familje, 400 paguajnë taksa. Ne po bëjmë projektin duke digjitalizuar dhe do mësojnë të dhëna analitike, në mënyrë manuale, me njerëz, me njësitë administrative

Ne kemi synuar rritjen e të ardhurave nga Shëngjini, nga turizmi. Ne p.s në 2018 e përpara ishin 80 mln lekë taksë fjetje, sivjet ne e kemi 350. Për stacionet e plazhit 180 mln mbledhnin, 550 ne. Ajo që ka ndodhur është që ne kemi rritur performancën duke mos kontrolluar dot sistemin e taksave në zonat rurale për shkak të mospasjes së informacionit, megjithatë ne do e marrim informacionin dhe do jemi të kujdesshëm. Ne prapë çojmë 60% në zonat rurale edhe në formën e mallrave e shërbimeve siç ka Afortini, sepse shumë fonde punë që ne i bëjmë në bujqësi, me kanalet kulluese. Ne po bëjmë projekte për sistemin e ujitjes me Ministrinë e Bujqësisë, jemi dakordësuar në parim. Në sistemin e kullimit, të paktën në Shëngjin tani kemi bërë një punë të jashtëzakonshme. Ka akoma. Ne do vazhdojmë të punojmë, nuk ndalemi asnjë ditë.

– Ndue Luli: Faleminderit. Ka pyetje të tjera?

Po zonja Hoxhia.

– Donika Hoxhia: Përshëndetje të gjithëve. Në fakt mendova që do bënim dhe diskutime në lidhje me buxhetin. Nuk do zgjatem. Nga ajo që pashë unë, e mendoni se shumë në planin e shpenzimeve për turizmin është e mjaftueshme, m'u duk se vetëm 2% e buxhetit i është kushtuar ndërkohë që ne jemi një bashki që mbështetemi te turizmi

detar, malor por edhe historik. Në lidhje me këtë, a nuk mund të ishte më shpejt vendosja e shtatores së Skënderbeut, pra mos të lihet për vitin 2026 por mund të bëhet diçka më shpejt sepse është pjesë e turizmit historik le të themi, për qytetin e Lezhës. Ju na folët për projekte. Nuk jam aspak ironike, shumë mirë, me projekte ecet përpara por më duhet të ndalem vetëm tek këto që kemi këtu. E kemi thënë dhe herë tjetër për projektin për studimin e përmbytjeve. Në fakt ju këtu flisni për hartimin e planit të studimit për rrezikun e përmbytjeve në 2026-n, pra hartimi i planit, pastaj zbatimi imagjino kur do jetë. Folëm dhe për projekte të shtyra në kohë për arsye të ndryshme që janë dhe objektive. A mendoni se duhet të nxitojmë pak sepse koha ecën për disa njerëz, që largohen nga jeta, po i parë të zbatuara këto projekte, nëse ne do i zgjasim kaq shumë? Edhe diçka tjetër. Për ndriçimin, për shkollat, do ishte shumë e domosdoshme ndërhyrja juaj. E them si mësuese, është një problem shumë i madh plotësimi i SMIP-it dhe shumë mësues detyrohen te marrin punën me vete edhe për arsye të mungesës së energjisë. Sepse kemi këto shkëputje. Do më lejoni të bëj një propozim, kjo nuk ka lidhje me këshillin, për një problematikë që po diskutohet tashmë për shkollat e Lezhës, shkollat e arsimit bazë kanë vendosur të marrin

një uniformë për fëmijët, thjesht po e shfrytëzoj këtë mikrofon tani për t'ia drejtuar drejtorive të shkollave që nuk mund t'i detyrojnë fëmijët, sigurisht që me shumicë votash ne e dimë që shumica vendos, por janë disa familje që e kanë të pamundur t'i mbajnë. Nuk del një kostum, për të mbyllur javën se fëmijë janë. Kjo ishte një thirrje.

Edhe diçka tjetër që e pashë këtu te buxheti, ndërtimi i qendrës së qenve endacakë kishte një buxhet dyfish më shumë se sa ndërtimi i qendrës rezidenciale të moshës së tretë. Mua më bëri përshtypje. Ndoshta dhe justifikohet nga ekonomistët, por unë në fakt nuk e kuptova. Te shkolla "Gjergj Fishta" te rruga pranë a mund të bëhet një ndërhyrje e shpejtë sepse është shumë keq, edhe te loggjia e pazarit, një pjesë e bizneseve i mbajnë dyert të mbyllura kur kalojnë makinat ~~x~~ sepse shumë mbushet me ujë kur bie shi. Ai plani është shumë i mirë, por ndoshta ndonjë ndërhyrje të shpejtë, nëse është e mundur. Faleminderit.

– Pjerin Ndreu: Më duhet t'ju falenderoj edhe juve e nderuar këshilltare për pyetje absolutisht me vend. Të nisim nga fundi. Në buxhet është reflektuar ndërhyrja e rehabilitimit të ujërave të bardha në rrugën "Vëllezërit Coku", se është një zonë shumë e ngarkuar me popullatë dhe se projekti që kemi nuk e kap. Te shkolla "Gjergj Fishta" jua bëra

të parti, për shkak të atij investimi gjigant, që për hir të së vërtetës duhet të na mirë kuptoni, është e ratifikuar në parlament, është e firmosur nga ne, nga KFW, nga qeveria shqiptare, nuk ka një element që e bllokon më. I vetmi element që e bllokoi, ishte pandemia. Ne, edhe ato rrugë që i rregulluam në qytet, i rregulluam në kuadër të tërmetit, sepse pallatet e reja ndërruan profilin e shkarkimeve dhe duke i hapë rrugët ato, unë nuk mund t'i mbajë rrugët të hapura 2 vjet, pritë kur vijnë gjermanët dhe e shtruan asfaltin, por qyteti do jetë një kantier ndërtimi dhe na mezi e presim. Mos kujto se nuk e di për atij te shkolla "Gjergj Fishta" por është një shpenzim kot. Në lagjen "Nënë Tereze" nuk kemi vënë një pozhdië, vetëm ndriçim kemi bërë. Ndërsa ndërtimin e qendrës për partë, unë e di se do ta bëjmë me donacion, me një donatore shtetase e Kosovës e cila ka ofruar një projekt shumë të madh për ta bëjë një qendër atraktive, që të jetë dhe e vizitueshme. Është një situatë e çuditshme, merr fugonin, mbushe me pen dhe shkon lëshoje diku në pazar. Se kush e bën, unë vetëm me ngjit roje. Ky është një problem. Ne shpenzojmë lekë për sterilizimin, kemi 2 vjet që e kemi vënë në buxhet. Kemi bërë një farë pune për mos të jenë më të rrezikshëm e infektues, por nuk mjafton

Në turizëm ke një problem. Ne, investimet që i kemi, i kemi në promocion ndërsa për sa i përket infrastrukturës atje, ne do hyjmë me bashkinë dhe me investimet e qeverisë. Do investohet muzeu arkeologjik që do i shërbejë turizmit, do bëjmë rrugën e Tabës që del nga Shëngjini dhe i shërben turizmit, Kulë-hidrovor i shërben turizmit, investimet në Tale, Grykë Lumi i shërbejnë turizmit. Pra, turizmi e merr investimin më shumë se se mendom, por në formën e infrastrukturës. Ne bëmë infopoint. E aplikuam me fonde të BE-së dhe e bëmë në mes të Shëngjinit. dhe ne do të vazhdojmë me mini-infopointe që t'i shtrijmë në të gjithë gjatësinë e bulevardit deri në Kune. dhe në Tale.
Janë disa gjëra që ne mund t'i bëjmë dhe me aplikime me fondet e huaja dhe janë shumë të ndjeshëm kështu investimeve në turizëm.
Për sa i përket shkollës dhe energjisë, unë kam biseduar dhe me shefin e UNDP-së, ata kanë një projekt për eficiencën e energjisë, e cila nuk do të thotë vetëm panele diellore por edhe veshje me kapotë të objekteve sepse fatura që paguan bashkia, duke pasur parasysh edhe rrjetin e ndriçimit publik, është e madhe. Qyteti ka qenë krejt në terr. Sot është me ndriçim LED Shëngjini dhe Lezha. Dhe tani që flasim, e kemi të fituar

projektin për ndriçimin LED në zonat rurale prej 400 mln.
Nëse më pyet mua, shtatorja e Skënderbeut duhet vendosur aty ku ishte planifikuar. Atëherë nuk kishin nxjerrë lejen e ndërtimit. Unë kam 3 vjet që kërkoj që ta vëmë. Kam dakordësi për një pikë këtu ku ta vëmë. Kur ne ramë dakord për ta vënë, doli që këto këtu nuk kishin paguar, 70 mln lekë. Takova dhe zotërinë që e ka bërë.
Unë mendoj që do ta gjejmë një zgjidhje. Kemi parë si variant lulishten përballë rrethrrotullimit të Skënderbeut, por gjithsesi me aprovimin e Institutit të Monumenteve.

- Donika Havhia: Në lidhje me flamurin blu, cilën shtrirje do ketë?
- Pjerin Ndreu: Komplet bregdeti jonë, i Shëngjinit deri në Tale. E kemi fituar ne me projekt të huaj. Nuk ka lidhje me ministrinë. Dy projekte për 10 ditë kemi fituar. Prandaj them unë që 1 mld i kemi investuar vetëm me projekte.
Dhe nuk mungon as përkushtimi dhe as agresiviteti im karshi punës sime. Jua kam treguar dhe në lidhje me OSHEE.
- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Jaku.
- Tonin Jaku: Përshëndetje të gjithëve
Përshëndetje z. Kryetar.
Para 2 muajve kam ngritur disa probleme në lidhje me zonën e Zejmenit. Prej tyre do kërkoja dy gjëra për sistemin ujitës dhe për rrugët urbane,

konkretisht në fshatin Fllanë. A është parashikuar diçka për rrugët urbane në zonën tonë?
Në lidhje me energjinë elektrike, u tha në interpelancë drejtori. Nuk kemi pasë më problem, na ka ndikuar shumë.

- Pjerin Ndreu: Në njësinë Zejmen, ne fillojmë pothuajse në të gjitha fshatrat me rrugët rurale. Ne do të mundohemi me ARRSH-në të rregullojmë rrugët urbane. Do shkojmë edhe në Bërzanë te rruga e varrezave.

Fondi i Zhvillimit ka hapur një program për suportimin e bashkive në rrugët rurale dhe unë pretendoj që në këtë program ne të marrim disa rrugë. Unë jam partizan për disa rrugë të Zejmenit, p.sh nga Eko-ja në Markatomaj dhe rruga e Trevit që është një katastrofë. Ne në 2025 do kemi tjetër mundësi me rrugët, do hyjmë masivisht.

- Ndue Luli: z. Trashaj e ka fjalën.
- Alfons Trashaj: Përshëndetje të gjithëve.

Përshëndetje z. Kryetar.

Nuk e di a mund të kete një ndërhyrje në fushën e sportit në shkollën Zejmen, që është kthyer në një "kullotë" dhe a mundet për furgonat që vijnë nga Laçi e Mirdita mos të hyjnë në Kodhë, të rrinë afër Gurrave diku, ku mund t'u caktoni një vend, se mundësi keni. Kaq kisha.

- Pjerin Ndreu: Atë fushën e sportit në Zejmen edhe

të Dojçit, unë i kam futur në projekt. E tejmenit është më e degraduar. Ngelet për të rikontaktuar me Armando Dukën. Ne jemi në kontakt me Ambasadën Sllovake, e cila ka financuar në Tiranë fusha, dhe unë e kam pritur ambasadorin këtu dhe ma ka dhënë fjalën që do financojë 1-2 fusha sporti.

- Ndue Luli: Vazhdojmë diskutimet.
Kush e do fjalën?
Po z. Kosova

- Sokeljon Kosova: Përshëndetje të gjithëve
Në lidhje me projektbuxhetin afatmesëm sidhe të 2024, po më kujtohet një periudhë e parë disa kohëve kur kishin dalë ca meme - rrugë, rrugë, rrugë. Po më gjen mirë që kjo u kthye edhe sot. Shoh këtu te investimet e 2024, pothuajse 70% e tërë investimet në rrugë, ndërkohë që në arsim, në shkolle, investimet në 2024 janë thuajse zero. Është jashtëzakonisht mirë dhe ka shumë nevojë që të investohet në rrugë në pjesën rurale, gjithashtu edhe urbane, por unë do ju bëj apel ta rishikojmë edhe me pak më shumë investime tek arsimi, te shkollat, te infrastruktura shkollore, e mirëmbajtjes, e ngrohjes. Për mendimin tim është jashtë kohe më të blejmë sobë me dru e të blejmë dru e të pretendojmë se do shkojmë në Europë. Diçka tjetër është edhe me investimet në bujqësi. Një bashki me kap sipërfaqe toke bujqësore të

punueshme, me vetëm 18 milionë investime në 2024 për mendimin tim është shumë ulët. Pavarësisht investimeve në sistemin kullues, duhet përpjetër të kemi 1 ose 2 projekte të reja të financuara në 2024 në bujqësi. Gjithashtu, u tha disa herë, duhet një vëmendje e shtuar për pyllëzimin. Është emergjencë për Lezhën, ashtu si dhe për gjithë Shqipërinë.
Kaq kisha.

– Pjerin Ndreu: E pare e punës, projektet për kopshtet, për shkollat nuk i reflekton zakonisht buxheti i bashkisë. Ne konkurojmë me projekte në Ministrinë e Arsimit. Besoj kaq gjë, ju që keni punuar në bashki, duhet të dini të përkthen. Ju e dini si i kemi lënë shkollat e Shëngjinit, Shënkollit, tërë Ishull Shëngjinin, shkolla "Gjergj Kastrioti", kopshti në Ishull Shëngjin, konvikti, kopshti te konvikti, çerdhja e qytetit ka qenë katastrofë. Biblioteka ka qenë pak më mirë, por Pallati i Kulturës... Ne do vazhdojmë me projekte. Edhe për qendrat sociale. Kur themi rrugë, rrugë, rrugë, ne i kemi bërë nja 100 km rrugë, kujdes t'i masim. Kjo sorkazëm me thënë të drejtën, nuk shkon në rastin konkret, sepse është një punë për t'u vlerësuar. Zonat rurale kanë mbetur mbrapa. Investimet në bujqësi, ne e themë, bujqësia ka pasë një pikë moretiku që kanë qenë kanalet e kullimit. A ke nevojë? Sa të duash. Kur ju thashë – s'kemi shitur asnjë litër naftë –

juve thashë t'i thërrisni pak memories, se mu atij te njësia jote Sovetjan shitej bidoni me naftë. Ti s'ke qenë pjesë e asaj, jo.
Ne kemi mbjellë diku te 6000 fidanë, nuk është se kemi ndenjur me projekte. Edhe Ministria e Bujqësisë ka projekte këtu

- Ndue Luli: Fjalën e ka z. Ndreca.
- Erin Ndreca: Përshëndetje të gjithëve
Përshëndetje z. kryetar.

Doja të thoja shumë gjëra por do t'i bie shkurt. sepse shoh që kemi kaluar në përsëritje dhe nuk mendoj se është në interesin e asnjërit këtu apo të pytetarëve. Së pari, në emër të mazhorancës dhe të përgëzoj opozitën të cilët e kanë rritur nivelin e debatit konstruktiv, pavarësisht se mbase hisi jo mirë. Duket sikur këtu jemi para bebogjyshit që shprehim dëshira personale. Edhe pse i përgëzoj, prapë më bën përshtypje që si është e mundur që një projekt buxhet që është pothuajse më i detajuari dhe me vlerën më të madhe, asnjëri nga këta nuk e ka burrërinë apo guximin që të thotë "BRAVO", deri këtu është mirë por mungon një apo dy. dhe vazhdojnë të përsërisim gjëra që vetë kryetari i shprehu që në fillim. Është projekti më i arritur deri më sot, por që nuk është projekti që i zgjidh të gjitha problemet. Për respekt të pytetarëve, për respekt edhe të

inteligjencës tonë këtu, ne do përsëritim gjëra që këtu flitën sepse dikush do ta thotë me patjetër. Dua të përgëzoj dhe administratën e bashkisë për këtë buxhet dhe dua të theksoj një shqetësim që ngriti z. Agostin që përderisa shumica e investimeve varet tek të ardhurat që bashkia do të mbledhë dhe jo nga fonde të deleguara, ju lutem shikoni t'i realizoni në mënyrën më të mirë të mundshme. Në emër të mazhorancës ju kërkoj që këtë projekt buxhet ta hedhim në votim.

- Ndue Luli: Po z. Marku, vetëm se në përsëritje mos të kalojmë.

- Rrok Marku: Gjatë muajit të kaluar morëm pjesë në zgjedhjet e kryepleqësisë. Unë vërej një problematikë që njerëzit janë shumë pak të interesuar për këto zgjedhje. Unë mendoj që shpërblimi i tyre është shumë i vogël, 40 mijë lekë të vjetra merr një kryeplak z. kryetar. Unë mendoj që këshilli ta shohë si problematikë, të paktën të paguhen sa 10% e administratorëve.

- Pjerin Ndreu: Është e përcaktuar në ligj sa se merr, por për mua është pak.

- Ndue Luli: Ju lutem të ndalemi te pikat e buxhetit. E ke fjalën z. Kosova.

- Sokeljan Kosova: Kryetari nga përmendi pak rrugën Milot - Bulldre, nëse keni informacion.

- Pjerin Ndreu: Kam informacion që brenda janarit

hapet thirrja, brenda prillit fillon puna.
Më është thënë se është zgjidhur problemi i rrugës Shëngjin - Velipojë dhe do fillojë puna intensivisht
- Ndue Luli: Z. Jaku e ka fjalën.
- Dad Jaku: Përshëndetje të gjithëve
Përshëndetje z. kryetar
Kisha një dy probleme në lidhje me bujqësinë.
Problemi i parë - hidrovori i Balldrenit. Është një ndër problemet më madhore për atë zonë.
A mundet bashkia të bëjë ndonjë projekt studim për të? Nuk është kompetencë e bashkisë kjo por të paktën komunikim me Ministrinë e Bujqësisë.
Për problemin e ujitjes, as kjo nuk është në juridiksionin e bashkisë, nqs marrim një nga Mati, zgjidh problemet. Faleminderit dhe i fton kolegët që të votojmë.
- Ndue Luli: Kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet me 23 vota PRO
5 vota KUNDËR (këshilltarët Donika Hoxha, Donika Ndoj, Sovetjen Kosova, Rrok Marku, Alfrida Marku)
1 abstenim (këshilltari Emanuel Përgjoka)
këshilltari Kristian Gjidodaj nuk votoi.
Vazhdojmë me pikat e tjera.
* Projekt vendim "Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes pyjore

në pronësi private, për ndërtimin e resortit turistik nga kompania "Gjergji" shpk", projekt vendim ky i shtyrë nga mbledhja e kaluar.

- Alfride Marku: Kam 3 pyetje para se ta kalosh në votim dhe nuk ke pse e kalon me kaq urgjencë.
- Gjergjin Ndreu: Është kaluar njëherë po debat. Është gabim në sipërfaqet.
- Ndue Luli: E kalojmë në votim.
- Alfride Marku: Nuk e ke me relacion o zotëri këtë p/vendim dhe po na vini në pozitë sepse kërkoni këtu me votu p/vendime, kur na argumentojmë kundër, silleni në mënyrë fyese ndaj nesh.
- Ndue Luli: ky projekt vendim është kaluar në komisionin e mbledhjes së nëntorit. Është lënë pa u futur në rendin e ditës për arsye kuorumi dhe tani u hodh në votë.
- Alfride Marku: Kam 3 pyetje para se ta hedhësh në votim. Je duke shfuqizu një vendim të mëparshëm që këta zotërinjtë këtu e kanë miratu duke mos ditur se ça është duke u miratu.
- Agostin Marku: Të lutem, kujt shkurt, vetëm një sqarim. Është i njëjti projekt vendim.
- Alfride Marku: Je duke shfuqizu një vendim. Kërkoj falje këshilltarëve që ke sjellë një projekt vendim të pasaktë.

- Agostin Marku: Kemi një projekt vendim të cilin e kemi miratu, dhe sot është i njëjti me atë, ka të njëjtin objekt, janë sektësuar vetëm ca të dhëna të hartës bashkëlidhur dhe nuk ka asnjë lloj ndryshimi. Faleminderit po falje.
- Ndue Luli: Ky është një vendim që do sjellë të ardhura për Bashkinë Lezhë.

Kush është dakord?

Miratohet me 26 vota PRO

1 votë KUNDER (këshilltarja Alfride Marku)

2 ABSTENIM (këshilltarët Kristian Gjidodaj, Emanuel Përgjoku)

Kalojmë te projekt vendimi "Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK".

Kush është dakord që t'i kalohet banesa qytetarit?

Miratohet me të gjitha votat PRO të këshilltarëve prezentë.

Kalojmë te projekt vendimi tjetër "Për përfundimin e procedurave për kalimin në pronësi nga Bashkia Lezhë tek subjektet përfituese, të njësive të banimit në ndërtesën (pallat) në lagjen "Besëlidhja", të rindërtuar për shkak të tërmetit"

Bëhet fjalë për dhënien e certifikatave të pronësisë gjithë atyre banorëve që morën

banesa në pallatin e rindërtuar.
Kush është dakord?
Miratohet me të gjitha votat PRO të këshilltarëve prezentë.
Projekt vendimi tjetër është "Për miratimin e linjave të transportit të nxënësve e mësuesve, pendrave të grumbullimit e biletave".
Siç e dini, çdo vit bëhet projekt vendim i tillë për transportin e nxënësve e mësuesve.
Kush është dakord?
Miratohet me të gjitha votat PRO të këshilltarëve prezentë.
Faleminderit.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI